



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Njoftim për vende të lira pune

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionin “Anketues terreni” për plotësimin e nevojave me punonjës mbështetës për kryerjen e aktivitetit “Përditësimi i hartave të zonave të censit 2019”.

TERMAT E REFERENCËS DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR STAFIN NDIHMËS TË ANGAZHUAR NË ANKETËN E PËRDITËSIMIT TË HARTAVE TË ZONËS SË CENSIT 2019

Termt e referencës për anketuesit

- Anketuesi është personi përgjegjës për përditësimin e hartës së zonës së censit dhe plotësimin e formularit të informacionit gjeohapsinor, sipas udhëzimeve të përgatitura nga specialistët përkatës të INSTAT-it dhe rekomandimeve ndërkombëtare;
- Anketuesi është i detyruar të ndjekë me përgjegjësi trajnimin, që do të organizohet nga stafi i INSTAT si dhe të studiojë udhërrëfyesin përpara se të shkojë në terren;
- Anketuesi duhet të ketë paraqitje serioze në punë, të sillet në mënyrë korrekte, të jetë i komunikueshëm dhe këmbëngulës për të marrë informacionin e kërkuar;
- Bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, anketuesi duhet të respektojë rregullat e konfidencialitetit;
- Në rast se anketuesit do t’i kërkohet informacion nga qytetarët për detyrën që po ushtron, duhet të jetë i gatshëm t’i sqarojë ata për çdo hollësi;
- Anketuesi, në çdo rast dhe në mënyrë të padiskutueshme duhet të prezantojë veten nëse i kërkohet dhe të tregojë mjetin identifikues dhe autorizimin e INSTAT-it, sepse kjo siguron vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij;
- Për problemet e ndeshura gjatë terrenit të vihet në dijeni, operatori GIS dhe përgjegjësi i aktivitetit të zyrës rajonale përkatëse;
- Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e anketuesit nuk mund t’i transferohen personave të tretë.
- Të vizitohet çdo ndërtesë pa përjashtim dhe të mbledhë informacionin në pajisjen smartphone në mënyrë korrekte dhe plotësisht.
- Të sigurohet që e gjithë zona e caktuar është e mbuluar, duke vizituar të gjitha ndërtesat.

Kriteret e përzgjedhjes së anketuesve:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë përfunduar minimalisht arsimin e mesëm;
- Të ketë njohuri të mira në orientimin në terren;
- Të jetë banor i bashkisë ku do të kryhet përditësimi i hartave;
- Të njohë mirë terrenin ku do të kryhet përditësimi i hartave;
- Të jetë i aftë për të përdorur një smartphone dhe i aftë për t'u përshtatur shpejt me qasjet dhe teknologjitë e reja.
- Të jetë në moshë 18-60 vjeç;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe i gatshëm për lëvizje në distanca të gjata;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Eksperienca të mëparshme në punën me hartat përbëjnë avantazh;

Për realizimin e këtij vrojtimi në terren do të rekrutohen **120 anketues** me kontratë pune, sipas tabelës së mëposhtme dhe periudhën e punës për secilin anketues.

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. **Kërkesën për aplikim ku të specifikohet bashkia për të cilën aplikohet**, sipas tabelës bashkëlidhur, si dhe interesi përse po aplikoni për këtë vend pune si dhe përshkrim të eksperiencave të mëparshme me punën me hartat nëse keni pasur të tilla;
2. Curriculum Vitae (CV) të përditësuar me datën dhe firmën e personit;
3. Fotokopje e pasaportës ose e kartës së identitetit
4. Fotokopje e diplomës së shkollës së mesme ose të lartë

Dorëzimi i dokumentave të bëhet brënda datës 23.02.2019 pranë Institutit të Statistikave me poste ose dorazi në adresën : “Institutit i Statistikave, rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1,Tiranë” , ose në postën elektronike vlasku@instat.gov.al

Mungesa e një prej dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi sipas kërkesave çon në mos marrjen parasysh të kërkesës së aplikantit/es.

Vendi, data dhe ora e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të INSTAT brënda 5 ditëve nga përfundimi i datës së aplikimit.

Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen për datën dhe vendin e zhvillimit të intervistës dhe në momentin e paraqitjes duhet të kenë me vete dokumentet e mëposhtme:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Vërtetim vendbanimi;
2. Një fotografi pasaporte /ID

Mungesa e paraqitjes në intervistë pa këto dokumente çon në skualifikimin e kandidatit të përzgjedhur.

Kandidatët fitues do të njoftohen në një moment të dytë për datën dhe vendin e zhvillimit të trajnimit.

Shpërndarja e anketës sipas bashkive

Bashkia	Numër anketues	Muaj pune
Berat	2	6
Ura Vajgurore	2	6
Kuçovë	2	6
Skrapar	1	6
Poliçan	1	6
Dibër	2	6
Bulqizë	1	6
Mat	1	6
Klos	1	6
Durrës	6	6
Shijak	1	6
Krujë	2	6
Elbasan	4	6

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Belsh	1	6
Cërrik	2	6
Peqin	1	6
Gramsh	2	6
Librazhd	1	6
Përrenjas	1	6
Fier	5	6
Patos	1	6
Roskovec	1	6
Lushnjë	4	6
Divjakë	2	6
Mallakastër	2	6
Gjirokastër	2	6
Libohovë	-	-
Dropull	1	6
Tepelenë	1	5
Memaliaj	1	6
Përmet	1	6
Këlcyrë	1	5
Korçë	3	6
Maliq	3	6
Devoll	2	6
Pustec	-	
Kolonjë	1	6
Pogradec	3	6
Kukës	2	6
Has	1	5
Tropojë	1	6
Lezhë	3	6
Mirditë	1	6
Kurbin	1	6
Shkodër	5	6

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Vau i Dejës	2	6
Pukë	1	6
Fushë Arrës	-	-
Malësi e Madhe	2	6
Tiranë	16	6
Kamzë	2	6
Vorë	1	6
Kavajë	3	6
Rrogozhinë	1	6
Vlorë	4	6
Selenicë	1	6
Himarë	1	6
Sarandë	1	6
Finiq	1	6
Konispol	1	3
Delvinë	1	4

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al